




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Datë: 18/3/2026

Mbështetur ne nenin: 12 paragrafi I te Rregullores se Ministrisë se Financave te Republikës se Kosovës nr.04/2017, mbi Financimin Publik të OJQ-ve, si dhe Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve , me nr. 3 1251 — 09/2022, Drejtoria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit shpallë:

THIRRJE PUBLIKE

Për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt propozimeve te OJQ-ve, për organizimin e aktiviteteve kulturore ne Komunën e Kamenicës.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ne Komunën e Kamenicës, u bënë thirrje OJQ-ve te regjistruara në Republikën e Kosovës, dhe individët që kane përvojë në organizimin e aktiviteteve kulturore te aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin dhe masivizimin e organizimeve kulturore, promovimin e artit përmes pasurimit, diversifikimit dhe rritjes se cilësisë së jetës kulturore ne Kamenice.

OBJEKTIVI SPECIFIK:

Ndërmarrja e iniciativave, përfshirja e individëve, grupeve dhe OJQ-ve në krijimin, masivizimin, rritjen e cilësisë, zgjerimin/shtrirjen e ngjarjeve/aktiviteteve kulturore, artistike si dhe përmirësimin e qasjes dhe përfshirjes së grupeve të marginalizuara.

OBJEKTIVAT TJERA:

- ❖ Krijimi i ngjarjeve/aktiviteteve kulturore, artistike nëpërmjet partneritetit me individët dhe grupet në fushën e kulturës dhe arteve;
- ❖ Përfshirja e ideve dhe potencialit të individëve dhe grupeve kulturore, sportive dhe rinore në funksion te masivizimit të ngjarjeve dhe aktiviteteve tradicionale;
- ❖ Rritja e cilësisë së krijimtarive në kulturë, arte dhe aktivitete rinore, nëpërmjet mbështetjes së ideve, propozimeve dhe ngjarjeve/aktiviteteve;
- ❖ Shtrirja dhe zgjerimi i ngjarjeve/aktiviteteve n zona rurale,
- ❖ Përmirësimin e qasjes dhe përfshirjes në ngjarje/aktivitete grupeve të marginalizuara

OJQ — të mund të aplikojnë me një projekt që kontribuon në organizime kulturore, përmes aktiviteteve si më poshtë:

Ngjarje/Aktivitete kulturore, artistike, tradicionale, edukuese, aftësuese:

1. Konkurse dhe aktivitete letrare
2. Festival i teatrove
3. Realizim i shfaqjeve teatrale
4. Organizimi i aktiviteteve në kuadër të festivalit Kamenica Summer Fest,
5. Konkurse të artit vizuel/ organizmi i ekspozitave
6. Mbrëmje folklorike të karakterit garues në nivel shtetëror e mbarëkombëtarë
7. Festivale
8. Manifestime si: shënimi i datave lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare si: 17 shkurti, Epopeja e UÇK-së, 1 qershor, 18 qershor, 28 nëntori, etj...
9. Panairë
10. Promovimi i turizmit kulturor
11. Realizimi i muraleve e veprave të ndryshme artistike
12. Realizimi i veprave artistike
13. Botime letrare e artistike
14. Projekte filmike artistike e dokumentare
15. Pjesëmarrje në gara dhe festivale regjionale dhe ndërkombëtare
16. Aktivitete garuese, kreative dhe/ose artizanale
17. Seminare dhe trajnime
18. Kurse për aftësim artistik e kulturor
19. Programe dhe gara shkollore
20. Aktivitete të ngjashme kulturore

Vërejtje: të gjitha aktivitetet duhet të zhvillohen brenda territorit të komunës së Kamenicës.

Kriteret për pjesëmarrje në thirrjen publike të subvencioneve për Kulturë, Rini dhe Sport:

- ✓ OJQ-të të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës,
- ✓ OJQ-të të cilët nuk e kanë përmbyllur raportin e subvencioneve të viteve paraprake nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Kamenicës në këtë thirrje dhe nuk mund të për zgjidhen fituese
- ✓ Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
- ✓ Projektet duhet të reflektojnë nevojat dhe objektivat e Komunës së Kamenicës për këto fusha;
- ✓ Të mos ekzistojë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- ✓ OJQ-të nuk mund të përfitojnë me dy ose më shumë projekte nga subvencionet e Komunës së Kamenicës brenda një viti, qoftë edhe në kategori të ndryshme. Si dhe kufizimet e parapara me rregulloren për subvencione të Komunës së Kamenicës.
- ✓ OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushat e cekura më lartë. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunës së Kamenicës dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.
- ✓ OJQ-të të cilat kanë raport negativ të evidentuar nga komisioni i monitorimit, nuk do të kualifikohen për mbështetje.

Lista e dokumenteve te thirrjes publike për OJQ-të:

- Certifikata e regjistrimit të OJQ-se;
 - Certifikata e numrit fiskal
 - Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (Jo kopje e kartelës bankare);
 - Kopjen e letërnjoftimit ose pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-se;
 - Vërtetimin që OJQ nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
 - Deklarata e financimit e dyfishtë
 - Deklarata e partneritetit;
 - Formulari i projekt-propozimit të thirrjes publike
 - Formulari i propozim-buxhetit
 - OJQ-të përfituese , përmes platformës E-Kosova duhet të regjistrohen në sistem – thesar , si OJQ – përfituese të subvencioneve (pas shpalljes së rezultateve)
- ✚ Kriteret e përgjithshme minimale për INIDIDËT te përcaktuara me dispozitat ne vijim:
- Aktiviteti doemos te realizohet ne Komunën e Kamenicës
 - Në rast se individi ka përfituar me parë mbështetje financiare publike, duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare;
 - Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera te financimit për të njejtat aktivitete;
 - Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikantit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit aplikantit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin fuqi Republikën e Kosovës.
 - Individët nuk kane te drejtë të aplikojnë me shumë se një projekt-propozim në këtë thirrje publike.

RAPORTIMET PËR PËRMBUSHJE TË AKTIVITETEVE TË PËRKRAHURA

Raporti Narrativ - i cili përfshin dëshmi nga projekti dhe përshkrim të aktiviteteve. Ky raport duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet nga personi që ka nënshkruar marrëveshjen për subvencione. Raporti duhet të dorëzohet pas përfundimit të projektit.

❖ Raporti narrativ i përgatitur duhet të përfshijë:

- Të përfshijë dokumentacion mbështetës (si foto, regjistrime të ndryshme të aktiviteteve. etj).

❖ Raporti Financiar

- Kërkohet që të përmbushen obligimet e raportit financiar njejtë sikurse të gjitha subjektet tjera juridike. Në përputhje me Ligjin nr. 04/L-57 të gjitha OJQ-të e regjistruara në Departamentin për OJQ, të cilave në vazhdimi u është dhënë statusi i Përfitimit Publik duhet të përgatisin raport vjetor të projektit .

- Raporti Financiar duhet të deklarohet dhe Të përshkruajë shpenzimet ne përputhje me buxhetin origjinal duke reflektuar shpenzimet e kërkuara dhe ato të kryera.
- Të përshkruaj çdo pajisje të blerë;
- Të evidentojë çdo fond të pashpenzuar (cilat duhet të kthej ose për të cilat kërkohet shtyrje e afatit .
- Raporti duhet të jenë të përshkruara ne mënyrë elektronike dhe të printuara;
- Raporti duhet të nënshkruhet nga një person ne pozicion drejtues;

BUXHETI PARAPARË

Komuna e Kamenicës për këtë thirrje publike ka planifikuar të ndajë vlerën totale 30,000.00 euro.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është 700.00 euro, ndërsa shuma maksimale për projekt është 6,000.00.

Kujdes: OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj ftese publike. Periudha e realizimit të projektit është më së largu nëntë (9) muaj pas nënshkrimit të kontratës.

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë të cilat së bashku me Udhëzimet për aplikantë janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes: <https://kk.rks-gov.net/Kamenicë>

FORMA E APLIKIMIT

Afati për aplikim për Subvencione në kategorinë subvencione për kulturë fillon prej datës **23.3.2026** deri me **15.4.2026**

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më **31.12.2026**.

Projekt propozimet mund të dorëzohen në dy forma:

- Aplikacionet e kompletuara me dokumentet e nevojshme dhe projekt propozimin sipas thirrjes publike mund të dorëzohen fizikisht ne qendrën për shërbime për qytetar;
- Përmes shërbimit postar në adresën e më Poshtme e Cila vlen për dy rastet e aplikimit:

KOMUNA E KAMENICËS

Rr. "Skënderbeu"

Objekti i Administratës Komunale

Qendra për Shërbim me Qytetarë

Vërejtje: Aplikantët duhet të sigurohen se aplikimi i tyre përmes shërbimeve postare, duhet të mbërrijë brenda afatit të paraparë në thirrje, në të kundërtën aplikimet që mbërrijnë jashtë kohës së thirrjes nuk do të merren në shqyrtim,

Dokumentet nuk pranohen pas mbylljes së thirrjes publike. Ngarkimi i dokumentit të gabuar ose jo të skanuar mirë, me pamje jo të qartë konsiderohet si mungesë e dokumentit. Nuk do të pranohet

ndryshimi i subjektit të aplikantit nga individ në cilindo variant tjetër, pas përfundimit të aplikimit.
E njëjta vlen edhe për ndryshim të xhirollogarisë

PROCESI I HAPJES DHE SHQYRTIMIT TË APLIKACIONEVE PËRFSHINË:

Vlerësimi administrativ - që identifikon nëse aplikanti ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse. Plotësimi i dokumentacionit pas afatit të aplikimit, përkatësisht gjatë periudhës së vlerësimit apo afatit të ankesave, nuk është i mundshëm.

Vlerësimi përmbajtjesorë : që vlerëson nëse:

Me rastin e vlerësimit të projekt-propozimeve, komisioni do të vlerësojë me sa vijon:

- aplikanti është i profilizuar në fushën e kulturës ;
- aplikanti ka aplikuar parimet e qeverisjes së mirë në zbatimin e programit respektiv në vitet paraprake;
- aplikanti ka paraparë zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë në zbatimin e projekt-propozimit të prezantuar në këtë thirrje publike;
- aplikanti posedon kapacitete profesionale dhe teknike për të zbatuar aktivitetet e planifikuara të projekt - propozimit; është përcaktuar ekipi i projekt-propozimit dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit;
- projekt-propozimi përputhet me fushëveprimin e kësaj thirrjeje publike;
- projekt-propozimi kontribuon në përmbushjen e objektivave të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse;
- aktivitetet e projekt-propozimit janë të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme;
- kostot e projekt-propozimit janë reale karshi rezultateve specifike dhe kohëzgjatjes së pritshme të projekt-propozimit;
- kostot e projekt-propozimit janë në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve. vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave. trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes, janë të detajuara në Rregulloren për subvencione,

Do të konsiderohen për mbështetje vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen te zyrtari përgjegjës *Azemine Maliqi* , në mënyrë elektronike duke dërguar e-mail në adresën: azemine.maliqi@arks-gov.net , ose në numrin kontaktues, 044 984 129 gjatë orarit të punës 8:00-16:00 (e hënë —e premte).

Drejtori
Arim Dervishi

